



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E EKONOMISE  
Drejtoria e Administrimit te Prones Publike

URDHER  
Nr. 28 Date 4.6.2003  
PER

BASHKIMIN E SH.A. "UJESJELLES-KANALIZIME QYTET" TIRANE  
NEPERMJET PERTHITHJES ME SH.A "UJESJELLES FSHAT" TIRANE SI  
DHE ME PERFSHIRJEN E REZERVAVE NE KAPITAL  
Drejtuar : Sh.A. "Ujesjelles-Kanalizime Qytet" Tirane

Duke marre parasysh shkresen Nr. 907 date 21.02.2003 te Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit "Kerkese per Nxjerrjen e Akteve Nenligjore per Bashkimin e Shoqerive te Ujesjelles-Kanalizime Qytet dhe Ujesjelles Fshat Tirane" si dhe Urdherin e Ministrit te Ekonomise Nr. 59 date 26.02.2003,

KONSTATOVA


Se praktika eshte e plote dhe per sa me siper, ne zbatim te Ligjit Nr. 8885 date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me akte te tjera ligjore, Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te Ligjit Nr. 7661, date 19.01.1993 "Per Kontabilitetin", neni 102 pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise

Urdheroj:

Ne aktet e themelimit si dhe ne statutin e shoqerise te Sh.A. "Ujesjelles-Kanalizime Qytet" Tirane te behen ndryshimet e meposhteme:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet, **nepermjet perthithjes se kapitalit te Sh.A "Ujesjellesin Fshat" Tirane per vleren 264.300.000 leke**, e barabarte me 264 300 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion, **si dhe me perfshirjen e rezervave, per vleren 288.371.000 leke**, e barabarte me 288.371 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion.
2. Kapitali Themeltar i Sh.A. "Ujesjelles-Kanalizime Qytet" Tirane, **te behet 2.561.571.000 leke** i barabarte me 2.561.571 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion.  
Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".  
Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

Arben MALAJ  
MINISTER



**RAPORT**  
|  
**EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR**  
**PER**  
**BASHKIMIN E SHOQERIVE SHA UJESJELLES-KANALIZIME QYTET ME**  
**SHA UJESJELLES FSHAT TIRANE .**

Zoterinj,

Ne zbatim te urdherit te Ministrit te Ekonomise, Nr.55 date 26.02.2003 "Per bashkimin e SH.A. Ujesjelles Kanalizime Qytet" me SH.A. "Ujesjelles Fshat" Tirane, ndermorem misionin e ekspertit kontabel te autorizuar per verifikimin e dokumentacionit te pergatitur per kete qellim si dhe te llogarive te deklaruar nga sejcila shoqeri ne bilancet e tyre date 31.12.2002.

Me qellim qe te respektohen rregullat e pajtueshmerise se misionit tone, organizuam punen ne menyre te pavarur duke u angazhuar per SHA Ujesjelles-Kanalizime Qytet Znj. Lefteri Kushta dhe per SHA Ujesjelles Fshat z. Ahmet Stojna. Ne perfundim, per te lehtesuar procedurat e bashkimit te shoqerive paraqesim nje raport te perbashket per sa me poshte vijon :

I. **TE PERGJITHESHME**

**a.- Per shoqerine "Ujesjelles-Kanalizime SH.A." Tirane ;**


Eshte krijuar me 5.12.2000 nga transformimi ne shoqeri tregtare i ndermarrjes me te njejtin emer dhe eshte rregjistruar ne Gjykate me 28.12.2000, Nr.24875 i Rregjistrit Tregtar. Kapitali i nenshkruar me daten 31.12.2002 eshte 2.008.900.000 leke, pa ndryshime qe nga data e themelimit te saj.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" SHA Tirane eshte "Prodhimi dhe furnizimi me uje te pijshem i popullates dhe gjithë subjekteve qe veprojne ne qytetin e Tiranës si dhe largimi i ujrave te perdorura qe ne kete qytet.

Gjate veprimtarise si shoqeri tregtare, Ajo ka rezultuar me fitim, marzhi i te cilit varion nga 5 deri ne 10 per qind mbi shifren e afarizmit.

**a.- Per shoqerine "Ujesjelles Fshat SH.A." Tirane ;**

"Ujesjelles Fshat" SH.A. Tirane eshte krijuar me 22.01.2002 nga transformimi ne shoqeri tregtare i ndermarrjes me te njejtin emer dhe eshte rregjistruar ne



Gjykate me 12.03.2002, Nr.27377 i Rregjistrat Tregtar. Kapitali i nenshkruar me daten 31.12.2002 eshte 264.300.000 leke, i perbere nga 264.300 aksione, pa ndryshime qe nga data e themelimit te saj.

Objekti kryesor i veprimtarise eshte prodhimi dhe furnizimi me uje te pijshem i popullates dhe gjithë subjekteve qe veprojne ne fshatrat e Tiranës. Kjo shoqeri nuk ushtron veprimtarine e largimit te ujrave te perdorura ne keto fshatra per shkak se nuk eshte realizuar bashkimi i ketyre veprimtarive per Fshatin. Me kete objekt vazhdon te merret Ndermarrja Komunale.

Gjate veprimtarise si shoqeri tregtare, Ajo ka rezultuar me humbje te medha, marzhi i te cilave varion nga 25 deri ne 45 per qind mbi shifren e afarizmit.

## II PER BASHKIMIN E SHOQERIVE

Bazuar ne Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe ne zbatim te Urdherit te Ministrit te Ekonomise shoqerite ekzistuese do te bashkohen nepermjet perthithjes se SHA Ujesjelles Fashat nga SHA Ujesjelles Kanalizime Qytet Tirane.

Per kete qellim nga Shoqerite u kryen veprimet kontabile per riformimin e Kapitalit te Nenshkruar te shoqerise se Re duke perfshire ne te edhe rezervat se bashku me pjesen perkatese te rezultatit financiar te trasheguara nga te dy shoqerite.


Ne kuadrin e ketij operacioni bashkimi verifikuam te gjitha llogarite perkatese te Shoqerive qe marrin pjese ne te. Ne perfundim kemi formuar opinionin tone se llogarite e deklaruar me 31.12.2002, nga e dyja shoqerite pjesemarrrese ne operacionin e bashkimit, jane reale dhe besnike

Teresia e elementeve te aktivitetit dhe te pasivitetit te bilancit te SA Ujesjelles Kanalizime Tirane pas bashkimit eshte sipas bilancit permbledhes date 31.12.2002, bashkelidhur ketij raporti.

## III. DISA KOMENTE PER BILANCIN PERMBLEDHES TE BASHKIMIT

### a.- Per Aktivin

- Aktive te qendrueshme pas bashkimit, me vlefte neto 5.894.448.735 leke te cilat zene 84 per qind te aktiveve gjithsej, jane krijuar me kontribut te SHA Qyteti 92,7 per qind dhe nga SHA Fshati 7,3 per qind.



Vleresimi i aktiveve te qendrueshme te trashiguara eshte bere ne momentin e krijimit te shoqerive sipas akteve nenligjore qe rregullojne transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare, ndersa per te tjerat vleresimi eshte bere sipas kosos historike. Amortizimi eshte llogaritur ne menyre analitike duke i u permbajtur parimeve e rregullave kontabile per kete qellim. Ne teresi AQT ne perdorim jane te amortizuara 37,3 per qind.

- Aktive qarkulluese prej 1.116.172.351 Leke jane 87,6 per qind te trashiguara nga SHA qytet dhe 13,4 % nga SHA Fshat. Ato perbehen nga :

- Gjendje te inventarit e ne proces 81.122.787 leke,
- Kerkesa per arketim mbi debitoret 833.951.115 leke , kryesisht faturat e pa arketuara nga shitja e ujit, prej tyre 15,6 per qind jane trashiguar nga SHA Fshati dhe 84,4 per qind nga SHA Qyteti.
- Likuiditete e vlera te tjera arke 201.098.449 leke nga te cilat 96,6 per qind trashigohen nga Sha Qyteti.

Keto aktive jane te analizuara, te vleresuara ,te dokumentuara dhe te deklaruar sipas rregullave kontabile.



#### **b. – Per Pasivin**

- Kapitali i nenshkruar i Shoqerise , pas kalimit ne kapital te rezervave te lidhura me te, eshte 2.561571.000 leke, i perbere nga 2.561.571 aksione , te zoteruara teresisht nga Shteti.

Nga ana e shoqerive pjesmarrse ne operacion nuk eshte bere vleresimi i aksioneve sipas gjendjes reale te kapitaleve te veta. Nga perlogaritjet e vleres se aksioneve duke marre parasysh gjendjen faktike te kapitaleve te veta (perjashtuar subveconet per investime) del se per SHA Qytet vlefte e nje aksioni eshte 1154 leke ndersa per SHA fshat eshte 961 leke ,pra raporti i kembimit te aksioneve eshte 1 me 0.83. Shkaku i kesaj gjendje jane humbjet e medha te trashiguara nga SHA Fshati.

- Detyrime te kerkueshme pas me shume se nje viti 3.788.156.650 leke perbehen kryesisht nga kredite e institucioneve nderkombetare, (kryesisht qeveria Italjane) per ndertimin e kompleksit te Bovilles dhe te rrjetit te ujesjellesit ne qytet
- Detyrime te kerkueshme brenda nje viti per 381.062.440 leke, jane te trashiguara 51 per qind nga SHA Qytet dhe 49 per qind nga SHA Fshati.

Detyrimet jane te analizuara dhe te dokumentuara. Ato jane klasifikuar dhe deklaruar deklaruar sipas parimeve e rregullave kontabile. Problematike jane

detyrimet ndaj Sigurimeve Shoqerore per 63.757.416 leke dhe ndaj Shtetit 26.275.588 leke per tatime, te cilat trashegohen nga SHA Fshati. Keto detyrime rendojnme gjendjen financiare te Shoqerise se Re dhe duhet te shlyhen sa me pare prej saj.

Nga veprimet per riformimin e kapitalit pas bashkimit, eshte paraqitur si detyrim ndaj buxhetit te shtetit 5.697.334 leke dividend sipas shkreses Nr.2933 date 15.04.2003 te Ministrise se Ekonomise per miratimin e shperndarjes se rezultatit te vitit 2002 te SHA Qytetit.


Llogari te tjera pasive per 1.478.000 leke eshte detyrim i shoqerise ndaj shtetit per nje makineri te veqar per privatizim ne momentin e transformimit, por qe ende nuk eshte privatizuar.

Perfundimisht, Bilanci i çeljes se shoqerise Ujesjelles Kanalizime SH.A. Tirane nga bashkimi nepermjet perthithjes me SHA Ujesjelles Fshat Titane me date 1.01.2003, eshte hartuar sakte dhe pasqyron ne menyre besnike operacionin e bashkimit.

**Kapitali i nenshkuar i SHA Ujesjelles Kanalizime Tirane nga 2.008.900.000 leke, pas bashkimit behet 2.561571.000 leke, i perbere nga 2.561.571 aksione , te zoteruara teresisht nga Shteti.**

Tirane me 20.05.2003

AHMET STOJNA



EKSPERTE KONTABEL TE AUTORIZUAR

LEFTERI KUSHTA



LEFTERI KUSHTA  
EKSPERTE KONTABEL  
LIC : 3809763

Ekspert Kontabël i  
Autorizuar  
AHMET STOJNA  
Nr. Lic. 54 TIRANE



REPUBLICA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E EKONOMISE

*Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme*

URDHER  
Nr. 15 Date 9.11.2004

PER  
NDRYSHIME NE AKTIN E THEMELIMIT DHE STATUTIN E SHOQERISE "UJESJELLES  
KANALIZIME" SH.A TIRANE.

*Drejtuar: Shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" Sh.a Tirane*

Ne baze te nenit 1 te ligjit nr. 8885, date 22.04.2002 "Per nje ndryshim ne ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me ligjet perkatese; ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", si dhe kerkesen nr.39, date 14.01.2004 te Drejtorise se Shoqerise, miratuar paraparakisht nga Keshilli Mbikqyres duhen bere ndryshime ne Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" Sh.a Tirane.

Persa me siper, ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise,

**URDHEROJ:**

*I. Ndryshimin ne Aktin e Themelimit te Shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" Sh.a Tirane si me poshte:*

**Pika 1,** ndryshohet dhe behet si vijon:

- Shoqeria Anonime "Ujesjelles Kanalizime" Sh.a Tirane eshte krijuar nga bashkimi nepermjet perthithjes te Sh.a "Ujesjelles Kanalizime Qytet" Tirane, me Sh.a "Ujesjelles Fshat" Tirane.
- Shoqeria e krijuar emertohet Sh.a "Ujesjelles Kanalizime" Tirane.
- Selia e shoqerise eshte ne adrese: Tirane, Rruga 5 Maji.
- Veprimtaria dhe funksioni i Shoqerise rregullohet nga legjislacioni ne fuqi dhe nga statuti i saj.

**Pika 2,** ndryshohet dhe behet si vijon:

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte:

- Prodhimi dhe Furnizimi me uje te pijshem i popullates dhe i te gjitha subjekteve te Tiranes si dhe largimi i ujrave te perdorura ne kete territor .
- Shfrytezimi dhe mirembajtja e pajisjeve, makinerive, rrjeteve inxhinierike dhe te gjitha pasurive te tjera te saj.

- Zgjerimi, modernizimi dhe riparimi i objekteve te saj.
- Ndertimi i burimeve te reja per prodhimin e ujit.
- Kryerja e aktiviteteve per studimin, projektimin, keshillimin dhe konsultimin per aktivitetet qe perfshin objekti i Shoqerise.
- Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion tregetar dhe financiar qe lidhet drejtpersedrejt ose terthorazi me objektin e saj.
- Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqerive te reja , si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera jashte vendit.

**Pika 4**, ndryshohet dhe behet si vijon:

- Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2,561,571,000 leke nga i cili vlere e truallit eshte 169,480,680 leke. Numri i aksioneve eshte 2,561,571 me vlere nominale 1,000 leke secili.

## *II. Ndryshimin e Statutit te Shoqerise "Ujesjelles Kanalizime Qytet" Sh.a Tirane si me poshte:*

**Neni 1**, ndryshohet dhe behet si vijon:

- Shoqeria Anonime "Ujesjelles Kanalizime" Sh.a Tirane eshte krijuar nga bashkimi nepermjet perthithjes te Sh.a "Ujesjelles Kanalizime Qytet" Tirane, me Sh.a "Ujesjelles Fshat"
- Shoqeria e krijuar emertohet Sh.a "Ujesjelles Kanalizime" Tirane.
- Selia e shoqerise eshte ne adrese: Tirane, Rruga 5 Maji.
- Veprimtaria dhe funksioni i Shoqerise rregullohet nga legjislacioni ne fuqi dhe nga statuti i saj.

**Neni 2**, ndryshohet dhe behet si vijon:

- Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte:
- Prodhimi dhe furnizimi me uje te pijshem i popullates dhe i te gjithe subjekteve te Tiranës si dhe largimi i ujrave te perdorura ne kete territor.
- Shfrytezimi dhe mirembajtja e pajisjeve, makinerive, rrjeteve inxhinierike dhe te gjithe pasurive te tjera te saj.
- Zgjerimi, modernizimi dhe riparimi i objekteve te saj.
- Ndertimi i burimeve te reja per prodhimin e ujit.
- Kryerja e aktiviteteve per studimin, projektimin, keshillimin dhe konsultimin per aktivitetet qe perfshin objekti i Shoqerise.
- Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion tregetar dhe financiar qe lidhet drejtpersedrejt ose terthorazi me objektin e saj.
- Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqerive te reja, si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera jashte vendit.

**Neni 3**, ndryshohet dhe behet si vijon:

- Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 2,561,571,000 leke nga i cili vlere e truallit eshte 169,480,680 leke. Numri i aksioneve eshte 2,561,571 me vlere nominale 1,000 leke secili.

**Neni 4**, ndryshohet dhe behet si vijon:

- Transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit do te kryhet me urdher te Ministrit perfaqesues i titullit pronar i prones publike, ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizimin.

**Ne nenin 5**, fjala "Drejtor" zevendesohet me fjalen "Drejtor i Pergjithshem".

**Neni 6, paragrafi i pare** ndryshohet dhe behet si vijon:

- Keshilli Mbikqyres perbehet nga 6 (gjashte) antare. Antaret e keshillit mbikqyres miratohen nga Keshilli i Ministrave me propozim te Ministrit perfaqesues i titullit pronar i prones publike.

**Neni 7, paragrafi i dyte** ndryshohet dhe behet si vijon:

- Keshilli mbikqyres mund te ngarkoje nje person si sekretar jashte anetareve te tij dhe cakton pagen e tij.

**Ne nenin 8**, riformulohet emertimi: **FUNKSIONI DHE VENDIMET E KESHILLIT MBIKQYRES**  
- Fjala "Drejtor" zevendesohet me fjalen "Drejtor i Pergjithshem".

**Neni 9**, ndryshohet dhe behet si vijon:

- Keshilli Mbikqyres emeron Drejtorin e Pergjithshem te Shoqerise.
- Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e Shoqerise nga Drejtori i Pergjithshem.
- Keshilli Mbikqyres ka te drejte te shqyrtoje dhe t'i propozoje per miratim Asamblese:
  - a. Percaktimin dhe ndryshimin e programit vjetor si dhe veprimtarine afatshkurter, afatmesem dhe afatgjate te Shoqerise.
  - b. Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar.
  - c. Hapjen e veprimtarise ose njesive te reja.
  - d. Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te Shoqerise brenda kufijve te ligjeve ne fuqi.
  - e. Krijimin e Shoqerive te reja dhe pjesemarrjen e kapitalit te Shoqerive te tjera brenda kufijve te ligjit dhe percaktimeve te nenit 2 pika 2.2 dhe 2.3 te ketij Statuti.
  - f. Marrjen e huave afatmesme, afatgjata-sipas legjislacionit ne fuqi.
- Keshilli Mbikqyres, me miratimin e Projekt Programit Ekonomik te Zhvillimit per vitin ne vazhdim, autorizon Drejtorin e Pergjithshem te Shoqerise per kryerjen e veprimeve sipas legjislacionit ne fuqi. Ne rastet kur eshte e nevojshme te lidhen kontrata, per furnizim mallrash apo sherbimesh, per investime apo veprime te tjera te cilat nuk jane parashikuar ne Programin Vjetor Ekonomik te Zhvillimit, Drejtori i Pergjithshem duhet te marre autorizimin e Keshillit Mbikqyres te Shoqerise per te vazhduar Procedurat.
- Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryeje ne cdo kohe verifikime dhe kontrole qe ai i cmon te pershtatshme dhe te njihet me dokumentacionin qe e gjykon te nevojshem per permbushjen e detyres se tij.
- Drejtori i pergjithshem i paraqet raport Keshillit Mbikqyres te pakten nje here ne muaj.
- Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar Drejtori i Pergjithshem duhet t'i paraqese Keshillit Mbikqyres llogarine vjetore me qellim verifikimin dhe kontrollin.



**Neni 10**, te ndryshohet dhe te behet si vijon:

- Shperblimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres do te behet sipas legjislacionit ne fuqi.

**Neni 11**, ndryshohet dhe behet si vijon:

### **DREJTORI I PERGJITHSHEM**

- Shoqeria administrohet nga Drejtori i Pergjithshem.
- Drejtori i Pergjithshem ka te drejte qe brenda kompetencave te tij tu jape nje ose disa punonjesve te Shoqerise, te drejten per te kryer veprime te vecanta apo kategori veprimesh, me te drejten e nendelegimit.
- Drejtori i Pergjithshem mund te zgjidhet edhe jashte te punesuarve ne Shoqeri.
- Nese nje anetar i Keshillit Mbikqyres emerohet Drejtor i Pergjithshem, mandati i tij ne Keshillin Mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet Drejtor i Pergjithshem ne me shume se nje shoqeri dhe as mund te jete anetar drejtorie ne nje shoqeri tjeter. Drejtori i Pergjithshem mund te shkarkohet nga Keshilli Mbikqyres per shkaqe te perligjura. Ne rast se i interesuari ka lidhur kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga funksioni i Drejtorit te Pergjithshem nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates se punes.
- Drejtori i Pergjithshem emerohet per nje periudhe kohe prej 4 (kater) vitesh.
- Ne raste te pushimeve dhe te mungesave te tjera te zgjatura, Keshilli Mbikqyres ben zevendesimin e tij.
- Drejtori i Pergjithshem mund te riemerohet.
- Paga e Drejtorit te Pergjithshem caktohet nga Keshilli Mbikqyres ne aktin e emerimit te tij.
- Drejtori i Pergjithshem ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te Shoqerise, sipas percaktimeve te Statutit dhe te legjislacionit ne fuqi.
- Drejtori i Pergjithshem lidh kontrate me Keshillin Mbikqyres per detyrimet qe rrjedhin nga administrimi i Shoqerise.
- Brenda 3 (tre) muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar Drejtori i Pergjithshem duhet t'i paraqese Keshillit Mbikqyres llogarite Vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli.
- Aktet me te cilat Shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve, duhet te nenshkruhen nga Drejtori i Pergjithshem ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte.
- Marrdheniet brenda Shoqerise percaktohen me rregullore qe miratohet nga Keshilli Mbikqyres.

**Neni 12**, ndryshohet dhe behet si vijon:

### **KOMPETENCAT E DREJTORIT TE PERGJITHSHEM**

- Drejtori i Pergjithshem ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te shoqerise.
- Ne marrdheniet me te tretet shoqeria mer persiper detyrime qe rrjedhin nga aktet e Drejtorit te Pergjithshem edhe kur keto tejkalojne objektin e veprimtarise se shoqerise pervec rastit kur shoqeria provon se te tretet e dinin se akti i drejtorise kapercente objektin e veprimtarise se shoqerise dhe vepronte me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.
- Klauzolat e Statutit qe kufizojne kompetencat e Drejtorit te Pergjithshem duhet te respektohen nga te tretet.
- Aktet me te cilat shoqeria mer persiper detyrimet ndaj te treteve duhet te nenshkruhen nga Drejtori i Pergjithshem ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte.

- Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore që miratohet nga Këshilli Mbikqyres.

Ne nenin 13, fjala "Drejtor" zëvendësohet me fjalen "Drejtor i Përgjithshëm".

Neni 14, ndryshohet dhe bëhet si vijon:

- Kontrolli i Shoqërisë ushtrohet nga eksperte kontabel të autorizuar, të cilët emërohen nga Ministri përfaqësues i titullit pronar i pronës publike dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Ne nenin 16, fjala "Drejtor" zëvendësohet me fjalen "Drejtor i Përgjithshëm".

Neni 17, paragrafi i fundit ndryshohet dhe bëhet si vijon:

- Përdorimi i fitimit pas zbritjes së rezervës ligjore, bëhet me urdher të Ministrit përfaqësues i titullit pronar i pronës publike.

Ne nenin 20, fjala "Minister i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit" zëvendësohet me fjalen "Minister përfaqësues i titullit pronar i pronës publike".

Neni 21 shfuqizohet.

III. Ngarkohet Drejtori i Shoqërisë "Ujesjelles Kanalizime" Sh.a. Tiranë të kryejë në Gjykatë procedurat e depozitimit të ndryshimeve në Aktin e Themelimit dhe në Statut.

IV. Urdheri nr.383, datë 26.11.2003 i Ministrit të Ekonomisë shfuqizohet.

Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

